Pesha specifike	2.66 T/m^3
Pesha volumore ne gjendje natyrore	1.94 T/m^3
Koeficienti i porozitetit	$c = 0.70$
Grada e lageshtise	$G = 0.90$
Moduli i deformacionit	$E = 98 \text{ kg/cm}^2$
Kendi i ferkimit te brendshem	18°
Kohezion	$C = 0.22 \text{ kg/cm}^2$
Ngarkesa e lejuar ne shtypje	1.80 kg/cm^2
Parametrat mekanike ne rrefshin e rreshgitjes	
Kendi i ferkimit te brendshem	10°
Kohezion	$C = 0.09 \text{ kg/cm}^2$

Shtresa-3: Perfaqesohet eluvion I formacioneve shkembore, argjilite, alevrolite dhe ranore me ngjyre bezhe ne gri, me pak lageshti, me cimentim shume te dobet. Jane te ngjeshura.


Vetit fiziko-mekanike per kete shrese jane:

Perberja granulometrike

Fraksioni argjilor < 0.005 mm	36.5 %
Fraksioni pluhuror 0.005-0.075mm	39.70 %
Fraksioni rere > 0.05 mm	20.60 %
Fraksioni zhavoror > 4.75 mm	3.20 %

Plasticiteti

Kufiri i siperm i plasticitetit	W _{rr} = 40.90 %
Kufiri i poshem i plasticitetit	W _p = 21.60 %
Numri i plasticitetit	F = 19.30
Pesha specifike	2.68 T/m ³
Pesha volumore ne gjendje natyrale	2.18 T/m ³
Moduli i deformacionit	E = 489 kg/cm ²
Kendi i ferkimit te brendshem	28°
Rezistenca ne Shtypje nje boshtore	R _{sh} = 12.80 kg/cm ²
Kohezion	C = 0.29 kg/ cm ²
Ngarkesa e lejuar ne shtypje	2.80 kg/cm ²



PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

1. Zona e studiuar perfaqeson nje teren pjesisht te pjerrret i cili ndertohet nga formacione gjysem shkembore te cilat me kalimin e kohes tjetersohen dhe krijojne kushte te pershtatshme per krijimin e zonave me rreshqitje.
2. Ne zonen e studiuar takohen depozitimet Neogjenike te cilat mbulohen nga mbulesa deluvialo eluviale.
3. Ne kete zone takohen depozitime argjilore me veti bymyese dhe tkurrese.
4. Zona e ndikimit shkon deri ne thellesine 1.80 metra nga siperfaqja e terrenit.
5. Ujrat siperfaqesore dhe ato teknologjike apo industriale duhet te disiplinohen ne menyre sa me te mire.
6. Autoret e studimit jane ne dispozicion te investitorit qofte per fazen e projektimit ashtu dhe per fazen e ndertimit te themeleve te objektit.
7. Ne fazen e shfrytezimit te objektit duhet te tregohet vemendje qe ujrat teknologjike te mos depertojne nen themelet e godines duke shkaterruar bazamentin e objektit.
8. Dherat e krijuara nga germimet per themelet e objektit duhet te sistemohen jashte sheshit te ndertimit.
9. Meqenese tabani I themeleve eshte me perberje argjilore te cilat kane veti, qe ne pranine e lageshtise te fryhen (te zbadhojne volumin e tyre) dhe ne prani te thatesires te cahen (zvogelojne volumin e tyre) thellesia e ndikimit te ketij fenomeni eshte 1.80 m nga siperfaqja e tokes natyrore. Rekomandojme qe objekti te behet me trotuare, per te eleminuar ndikimin negative te ketij fenomeni ne muret e objektit si dhe tabanin e katit perdhe.

**STUDIM INXHINIERO-SIZMOLOGJIK
I SHESHIT TE NDERTIMIT TE NJE OBJEKTI**

**" INVESTIME PËR TRANSFORMIMIN E ASETVE PUBLIKE ME
POTENCIAL ZHVILLIMI NË MODELE TË STANDARTIT MË TË LARTË
TË ZHVILLIMIT, LOTI 1 "PARKU MULTIFUNKSIONAL, TIRANË "**

POROSITES: FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

Përgatitur nga:

NOVA CONSTRUCTION 2012 SH.P.K.

Lic. Nr. N.7016/1

Elda Vercani

1	HYRJE	3
2	SIZMICITETI I ZONES	3
2.1	Aktiviteti Sizmik i Zones	5
2.2	Akselerimi Sizmik Maksimal	8
3	KLASA E STRUKTURES SE PROJEKTUAR	8
4	KATEGORIA E TERRENIT	10
5	VLERËSIMI PROBABILITAR I RREZIKUT SIZMIK TË SHESHIT TË NDËRTIMIT	15
6	KONKLUZIONE	22
7	REFERENCA	23

1 HYRJE

Ky raport eshte pergatitur ne perputhje me kerkesen per te percaktuar rrezikun sizmik ne sheshin e ndertimit. Percaktimi i rrezikut sizmik se zones, ku struktura do te ndodhet do te mundesoje firmen projektuese, qe te kete aftesine te percaktoje forcat sizmike dhe ti perfshije ato gjate projektimit. Kjo do te lejoj kombinimet e duhura te forcave te perftohen duke bere te mundur percaktimin e madhesis se kolonave, trareve, sasine e hekurit perforcues etj.

Rreziku sizmik i sheshit te ndertimit eshte percaktuar duke u bazuar ne kodin European te ndertimit: *BS EN1998-1-1: General Rules, Seismic Actions and Rules for Buildings* (Eurocode 8). Ky standard eshte me bashkohori dhe perdoret gjeresisht ne te gjitha shtetet e Bashkimit European, duke prezantuar metodologjine me te avancuar ne perlllogaritjen e spektrave sizmike, te nevojshme per projektim strukturor. Me ane te spektrave sizmik, forcat qe gjenerohen nga nje termet mund te kalkuloohen dhe te aplikohen me forcat e tjera duke u bazuar ne kombinimin e forcave qe jepen ne BS EN 1991: Actions (Eurocode 1).

Prodhimi i spektrave sizmike (si rrjedhoje I forcave sizmike) ne kete nivel garanton qe godina te vazhdoje te jete funksionale pas nje termeti me magnitudo te rralle. Kjo nenkupton qe struktura do te pesoje lekundje gjate termetit por do te mbaje aftesine e transferimit te forcave vertikale dhe laterale ne themele dhe gjithashtu do te kete aftesi te perballoje tronditjet qe ndjekin zakonisht nje termet (aftershock). Ne baze te ketij kriteri, spektri sizmik eshte kalkuluar per nje termet qe ka probabilitet te ndodhe 1 here ne 475 vjet ose ka probabilitet prej 10% te tejkaloj ne magnitudo nje termet qe ndodh 1 here ne 50 vjet.

Metoda e prezantuar ne Eurocode 8 kalkulon spektrin sizmik duke marre si referencee akselerimin tokesore maksimal (PGA). Metodologjia e perdorur siguron nivelin e duhur te konfidences qe spektri sizmik eshte perftuar ne menyre konservative dhe qe aplikimi i tij te behet ne menyre te sakte. Kjo do te garantoje qe shembja e nderteses te parandalohet. Per me teper, duke qene se ne metodologjine e perdorur merren parasysh nje sere faktoresh te rendesishem si: forma e nderteses, qellimi i perdorimit te nderteses, formimi gjeologjik i sheshit, sizmiciteti i zones dhe materiali i perdorur per te ndertuar strukturen. Te gjitha keto karakterisitka jane zhvilluar ne seksionet e meposhtme te raportit dhe influenza e tyre, ne rezultatin final, behet e qarte.


2 SIZMICITETI I ZONES

2.1 Aktiviteti Sizmik i Shqiperise dhe veçanerisht i territorit te Bashkise te Tiranës

Zona per te cilen paraqitet ky studim ndodhet ne pjesen jugore te Tiranës. Objekti pozicionohet ne qytetin e Tiranës ne Lunder. Mundesohet aksesim ne objekt nepermjet rruges "Rezervat e Shtetit".



Pamje Satelitore, Ortofoto



Planvendosja e Objektiv

Ne zonimin sizmik mbareboteror, Shqiperia ze vend ne brezin sizmik Alpin-Mesdhetar, i cili eshte nder me aktive ne bote. Çdo vit ne kete rajon ndodh te pakten nje termet me $M > 6.5$ (Papazachos, 1989).

Shumica e termeteve te forte ndodhin ne 3 breza sizmike mire te percaktuar, si vijon:

- Brezi termetor Adriatiko-Jonik ne buzen lindore te mikroplakes se Adrias me shtrirje veriperendim-juglindje;
- Brezi termetor Peshkopi-Korçe me shtrirje veri-jug, dhe
- Brezi termetor Lushnje-Elbasan-Diber me shtrirje veri-lindore.

Epiqendrat e termeteve perqendrohen kryesisht gjate shkeputjeve ose zonave te shkeputjeve active.

Sizmiciteti i Shqiperise karakterizohet nga nje mikroaktivitet sizmik intensiv ($1.0 < M \leq 3.0$) nga shume termete te vegjel ($3.0 < M \leq 5.0$) nga termete te rralle me madhesi mesatare ($5.0 < M \leq 7.0$) dhe shume rralle nga termete te forte ($M > 7.0$).

Zona e Farkes, qe ben pjese ne zonen sizmoaktive Joniko-Adriatike, vleresohet me potencial sizmik me magnitudo **6.0-7.0 balle shkalla Rihter dhe intensitet epiqendror 8-9 balle**

MSK-64.



Figure 1: Harta me termet me magnitude mbi 5.5 qe kane ndodhur ne 50 vitet e fundit

Ne harten sizmotektonike te Shqiperise jane paraqitur shkeputjet aktive me tipin e deformacionit dhe kronologjine e aktivitetit te tyre, epiqendrat e termeteve sipas magnitudes, si dhe izovijat e intensiteteve maksimale te vrojtuar. Dy zona gjatesore dhe dy zona terthore te shkeputjeve aktive evidentohen mire ne orogjenin Shqiptar, si vijon:

1. Zona Joniko-Adriatike e shkeputjeve mbihipse me shtrirje VP deri afersisht VVP,
2. Zona Peshkopi-Korçë e shkeputjeve normale grabenore me shtrirje V-J,
3. Zona Shkoder-Tropoje e shkeputjeve normale me shtrirje VL,
4. Zona Elbasan-Diber e shkeputjeve normale me shtrirje VL.




Fig. 43: Harta sizmotektonike e Shqipërisë në shkallë 1: 500.000



Akselerimi Sizmik Maksimal

Akselerimi maksimal i terrenit (PGA) peshkruan akslerimin me amplitude me te madhe gjate lekundjeve sizmike ne nje pike gjeografike te caktuar. Lekundjet sizmike zakonisht ndodhin ne tre drejtime te ndryshme (dy horizontale dhe nje vertikale) dhe si pasojë PGA mund te specifikohet per secilin drejtim

Vlera e PGA per zonen e Farkes, per nje termet qe ndodh 1 here ne 475 vjet eshte marre ne baze te katalogut administrative per hartat probabilitare te hazardit sizmike

Akselerimi horizontal maksimal I terrenit $a_{gR} = 0.298g$

Duke u bazuar ne klauzolen 3.2.2.3 te Eurocode 8 dhe ne faktin qe Shqiperia ndodhet ne nje zone me aktivitet te larte sizik, PGA ne drejtimin vertikal perftohen duke perdorur formulen e meposhtme:

$$\text{Akselerimi vertikal maksimal i terrenit} \quad \mathbf{a_{vGR} = 0.9 \cdot a_{gR} = 0.268 \text{ g}}$$

Pas percaktimit te PGA per dy drejtimet horizontale dhe ate vertikal, do te proçedohet me percaktimin e parametrave te tjera.

3 KLASA E STRUKTURES SE PROJEKTUAR

Eurocode 8 i ndan strukturat ne kater klasa te ndryshme rendesie.

Standarti e reflekton rendesine e struktures me ane te nje faktori rendesie qe perdoret per te faktorizuar PGA, i cili u percaktua ne kapitullin e mesiperm. Faktori i rendesise varet nga shpeshesia e eventit sizmik. Ne Figuren 4 me poshte, faktoret per nje event sizmik qe ndodh 1 here ne 475 vjet.

Strukturat qe jane planifikuar te ndertohen jane konceptuar qe te perdoren si godinë hotelerie studentore. Kjo do te thote se probabiliteti qe njerez do te ndodhen brenda struktures eshte e larte. Per kete arsye struktures, sipas udhezimit te tabelës ne Figuren 4, do ti percaktohet nje klase rendesie ekuivalente me 3.

Importance class	Buildings	γ_i
I	Buildings of minor importance for public safety, e.g. agricultural buildings, etc.	[0.8]
II	Ordinary buildings, not belonging in the other categories.	1.0
III	Buildings whose seismic resistance is of importance in view of the consequences associated with a collapse, e.g. schools, assembly halls, cultural institutions etc.	[1.2]
IV	Buildings whose integrity during earthquakes is of vital importance for civil protection, e.g. hospitals, fire stations, power plants, etc.	[1.4]

Figure 2: Tabela me klasat e renesises se strukturave dhe faktoret e rendesise perkates

Per nje strukture me klase rendesie 3, faktori qe do ti aplikohet PGA eshte

$$\text{Faktori i rendesise} \quad \gamma_f = 1.0$$

Si rrjedhoje PGA per dy drejtimet horizontale dhe ate vertiakal rriten **perkatesisht 1.0 here.**

Akslerimi sizmik horizontal $a_g = a_{gR} \times \gamma_f = 0.298 g \times 1.0 = 0.298 g$
per llogaritje:

Akslerimi sizmik vertikal per $a_{vg} = a_{vgR} \times \gamma_f = 0.268 g \times 1.0 = 0.268 g$
llogaritje:

4 KATEGORIA E TERRENIT

Struktura gjeologjike e terrenit, ka nje rendesi te vecante ne percaktimin e spektrit sizmik te akselerimit si dhe sjelljen e struktures gjate nje termeti. Per kete arsye nje studim gjeologjiko-inxhinierike eshte kryer ne menyre qe te mundesoje strukturen gjeologjike te sheshit te ndertimit. Rezultatet e studimit gjeologjiko-inxhinierik jane pershkruar ne raport.

Shtresat e identifikuara gjate raporti gjeologjike dhe studimit jane paraqitur me poshte:
Vetite fiziko – mekanike te shtresave:

Shtresa-1: Perfaqesohet nga toka vegjetale perbehet nga suargjila te mesme, me ngjyre kafe ne bezhe me lageshti ne gjendje plastike, permbajne rrenje bimesh. Jane pak te ngjeshura.

Shtresa-2: Perfaqesohet nga suargjila te mesme deri te lehta, me ngjyre beshe me njulla grid he kafe me lageshti ne gjendje plastike. Permbajne shtresa te holla surerash. Eshte pak deri mesatarisht e ngjeshur. Vetite fiziko-mekanike jane:

Perberja granulometrike

Fraksioni argjilor < 0.005 mm	38.7 %
Fraksioni pluhuror 0.005-0.075mm	34.20 %
Fraksioni rere > 0.05 mm	18.60 %
Fraksioni zhavoror > 4.75 mm	8.50 %

Plasticiteti

Kufiri i siperm i plasticitetit	W _{rr} = 42.80 %
Kufiri i poshtem i plasticitetit	W _p = 21.40 %
Numri i plasticitetit	F = 21.40
Lageshtia natyrore	W _n = 24.60 %
Pesha specifike	2.66 T/m ³
Pesha volumore ne gjendje natyrale	1.94 T/m ³
Koeficienti i porozitetit	c = 0.70
Grada e lageshtise	G = 0.90
Moduli i deformacionit	E = 98 kg/cm ²
Kendi i ferkimit te brendshem	18°
Kohezion	C = 0.22 kg/ cm ²
Ngarkesa e lejuar ne shtypje	1.80 kg/cm ²
Parametrat mekanike ne rrefshin e rreshgitjes	
Kendi i ferkimit te brendshem	10°
Kohezion	C = 0.09 kg/ cm ²

Shtresa-3: Perfaqesohet eluvion I formacioneve shkembore, argjilite, alevrolite dhe ranore me ngjyre bezhe ne gri, me pak lageshti, me cimentim shume te dobet. Jane te ngjeshura. Vetit fiziko-mekanike per kete shrese jane:


Perberja granulometrike

Fraksioni argjilor < 0.005 mm	36.5 %
Fraksioni pluhuror 0.005-0.075mm	39.70 %
Fraksioni rere > 0.05 mm	20.60 %
Fraksioni zhavoror > 4.75 mm	3.20 %

Plasticiteti

Kufiri i siperm i plasticitetit	W _{rr} = 40.90 %
Kufiri i poshtem i plasticitetit	W _p = 21.60 %
Numri i plasticitetit	F = 19.30
Pesha specifike	2.68 T/m ³
Pesha volumore ne gjendje natyrale	2.18 T/m ³
Moduli i deformacionit	E = 489 kg/cm ²
Kendi i ferkimit te brendshem	28°
Rezistenca ne Shtypje nje boshtore	R _{sh} = 12.80 kg/cm ²
Kohezion	C = 0.29 kg/cm ²
Ngarkesa e lejuar ne shtypje	2.80 kg/cm ²

Jane bere matje ne sheshin e ndertimit te objektit "NDERTIMI I QENDRES SE INTEGRUAR NE FUNKSION TE SHERBIMEVE TE ADMINISTRATES PUBLIKE", me metoden MASW, ku jane marre disa profile sipas permasave te sheshit te ndertimit dhe ne menyre te detajuar jepet me poshte grafiku I nxjerre nga metoda si dhe grafiku i shperjtesise se valeve terthore Vs. Mbi kete baze eshte nxjerre shpejtesia Vs30 dhe nga vlera e saj eshte percaktuar kategoria e truallit. Keto vlera jepen ne grafiket perkates. Vlera e vs30 = 390.5 m/sek. Kjo vlere perkon me vlerat perkatese ne Eurocode 8, per kategorine B te truallit.



Kurba e ndryshimit të Vs në sheshin e ndërtimit dhe vlera e parametrin VS30

$VS_{30m} = 390.5 \text{ m/sec}$

Baza e klasifikimit te terreneve sipas Eurocode 8 eshte permbledhur ne tabelen e meposhtme.

Ground type	Simplified description of stratigraphic profile	Parameters				
		$V_{s,30}$ (m/s)	N_{SPT} (blows/30cm)	C_u (kPa)	Ménard Pressuremeter	
					E_m (MPa)	P_{lim} (MPa)
A	Rock or other rock-like geological formations	> 800	–	–	>100	>5
B	Deposits of very dense sand, gravel, or very stiff clay	360 – 800	> 50	> 250	25 – 100	2 – 5
C	Deposits of dense or medium dense sand, gravel or stiff clay	180 – 360	15 – 50	70 – 250	5 – 25	0.5 – 2
D	Deposits of loose-to-medium, or soft-to-firm clay	< 180	< 15	< 70	< 5	< 0.5
E	Type C or D soils between about 5m and 20m, overlaying Type A materials					
S ₁	Deposits with more than 10m of soft clays or silts with a high plasticity index ($PI > 40$) and water content	< 100 (indicative)	–	10 – 20		
S ₂	Deposits of liquefiable soils or sensitive clays not included in types A – E or S ₁					

Figure 3: Kategorizimi i Terrenit Sipas Eurocode 8

Duke u bazuar ne rezultatet e studimit gjeologjiko – inxhinierike, shpejtesise se valeve dhe tabelës se mesiperme, është e qarte, qe struktura do te ndertohet **ne nje terren te tipit B**.

5 VLERËSIMI PROBABILITAR I RREZIKUT SIZMIK TË SHESHIT TË NDËRTIMIT

Vlerësimi probabilitar i rrezikut sizmik për konditat e shkëmbit të fortë për sheshin e ndërtimit të kësaj strukture për të dy kushtet e performancës: “kushtin e dëmtimeve të kufizuara” dhe “kushtin e mos-shëmbjes” (përkatësisht, atë me probabilitet tejkalmimi 10% në 10 vjet, periudhë përsëritje 95 vjet dhe probabilitet tejkalmimi 10% në 50 vjet, periudhë përsëritje 475 vjet), bazohet në rekomandimin e ofruar nga IGJEUM-i (<https://geo.edu.al/newweb/?fq=brenda&gj=gj1&kid=44>) për rrezikun sizmik në këtë shesh ndërtimi, në zbatim të VKM Nr. 1162, datë 24/12/2020 dhe publikuar në Fletoren Zyrtare 10/2021 në 20 Janar 2021.

Vlerat e rrezikut sizmik për këtë shesh ndërtimi, për të dy nivelet e performancës në kondita shkëmbi të fortë (Trull i Tipit B sipas EC8), janë paraqitur në Tabelën 1.

Tiranë	Tiranë	0.144	0.293
	Petrelë	0.150	0.302
	Farkë	0.148	0.298
	Dajt	0.144	0.291
	Zall-Bastar	0.140	0.281
	Bërzhitë	0.157	0.315
	Krrabë	0.161	0.323
	Baldushk	0.148	0.300
	Shëngjergj	0.156	0.309
	Vaqarr	0.143	0.294
	Kashar	0.140	0.290
	Pezë	0.142	0.292
	Ndroq	0.140	0.292
	Zall-Herr	0.140	0.287

Tabela 1. Rreziku sizmik për Bashkinë Tirane

Përsa i takon spektrave të reagimit, Eurokodi 8 përshkruan dy spektra të veçantë projektimi për të marrë në konsideratë rrezikun sizmik në zonat me sizmicitet të lartë dhe të ulët. Tipi 1 i spektrit përshkruan rrezikun në zonat me sizmicitet të lartë. Kodi rekomandon të përdoret Tipi 1 i spektrit nëse tërmetet që kontribuojnë më shumë në rrezikun sizmik kanë magnitudë të valëve sipërfaqësore, M_s më të madhe se 5.5. Tipi 2 i spektrit rekomandohet nëse tërmetet që kontribuojnë më shumë në rrezikun sizmik kanë magnitudë të valëve sipërfaqësore, M_S më të vogël se 5.5. Të dhënat mbi sizmotektonikën dhe sizmicitetin e zonës së Shkodrës dhe rajonit përreth sugjerojnë ndodhjen e tërmeteve me magnitudë më të madhe se 5.5. Në Tabelat 2 dhe 3 paraqiten vlerat e parametrave që përshkruajnë format standarde të Tipit 1 të spektrave elastikë horizontalë dhe vertikalë të reagimit në EC8.

Kështu, spektrat e projektimit për objektin "NDERTIMI I QENDRES SE INTEGRUAR NE FUNKSION TE SHERBIMEVE TE ADM PUBLIKE", për të dy nivelet e performances janë llogaritur duke marrë parasysh se Tipi 1 i spektrave përfaqëson në mënyrë të përshtatëshme rrezikun sizmik në vendin e projektit.

Tipi i Truallit	S	T_B (s)	T_C (s)	T_D (s)
A	1.0	0.15	0.4	2.0
B	1.2	0.15	0.5	2.0
C	1.15	0.20	0.6	2.0
D	1.35	0.20	0.8	2.0
E	1.4	0.15	0.5	2.0

Tabela 2. Vlerat e parametrave që përshkruajnë Tipin 1 të spektrave elastikë horizontalë të reagimit sipas EC8

Spektri	a_{vg}/a_g	T_B (s)	T_C (s)	T_D (s)
Tipi 1	0.90	0.05	0.15	1.0
Tipi 2	0.45	0.05	0.15	1.0

Tabela 3. Vlerat e parametrave që përshkruajnë Tipin 1 të spektrave elastikë vertikalë të reagimit sipas EC8





Figure 4: Spektrat elastikë horizontalë dhe vertikalë të reagimit për të dy nivelet e performancës sipas EC8 per Sheshin e Ndertimit



6 KONKLUZIONE

Rreziku sizmik eshte percaktuar duke u bazuar ne metodologjine e pershkruar ne Eurocode 8 dhe rezultatet jane krahasuar me rezultatet e perftuara duke perdorur modelin sizmik te prodhuar nga KES.

Zona e Shqiperise ka nje aktivitet te larte sizmik dhe per kete arsye eshte e keshillueshme qe te perdoret spektri sizmik elastik te akselerimit per drejtimin horizontal dhe vertikal gjate projektimit te strukture. Perdorimi i spektrave elastik do te bej te mundur qe struktura te perballoj forcat e gjeneruara gjate nje eventi sizmik dhe ti transferoje ne themele. Gjithashtu, perdorimi i spektrave elastik do te mundesoj qe struktura te mbetet ne zonen elastike duke shmangur demtime strukturene ne kollona dhe trare.

Mbeshtetur ne materialin e trajtuar ne kete studim inxhinero-sizmologjik per vleresimin e rrezikut sizmik me programe te avancuara kompjuterike, specifike, publikimit te IGJEUM ne

faqen zyrtare (<https://www.geo.edu.al/newweb/?fq=brenda&gj=gj1&kid=44>) ne raport me sheshin e ndertimit te objektit "NDERTIMI I QENDRES SE INTEGRUAR NE FUNKSION TE SHERBIMEVE TE ADM PUBLIKE", nxirren keto perfundime kryesore:

Trualli ne sheshin e zhvillimit te projektit klasifikohet i Tipit B sipas Eurokodit 8 me $VS30 = 390.5$ m/sek

2. Nxitimi maksimal per "kushtin e mos-shembjes" ne bazamentin e ketij sheshi ndertimi eshte vleresuar nepermjet metodës probabilitare $PGA=0.298g$. Ketij parametri i korrespondon nje periudhe perseritje 475 vjet (90% mostejkalim ne 50 vjet). Per nivelin 90 mostejkalim ne 10 vjet (periudhe perseritje 95 vjet) kemi vleren $PGA=0.148g$. Si baze per kete vleresim eshte pranuar rekomandimi i IGJEUM-it per vleresimet probabilitare te rrezikut sizmik ne territorin e Shqiperise (IGJEUM, 2021).

3. Duke patur parasysh sizmicitetin perreth zones se Njesise Administrative Farke, me termete me magnitude me te madhe se 5.5, llogaritjet e spektrave horizontale dhe vertikale sipas Eurokodit 8 jane kryer duke patur parasysh Tipin 1 te spektrit sipas EC8.

4. Rekomandojme qe te perdoret standardi i Eurokodit 8 per projektimin e struktures ne kuader te projektit "NDERTIMI I QENDRES SE INTEGRUAR NE FUNKSION TE SHERBIMEVE TE ADM PUBLIKE", duke marre ne konsiderate te dy nivelet e veprimit sizmik per kerkesen e "mos-shembjes" dhe per kerkesen e "demtimeve te kufizuara". Konkretisht:

Per kushtin e "mos-shembjes" per spektrin elastik horizontal te projektimit te merret ne konsiderate Faktori i Rendesise sipas EC8 te barabarte me $\gamma_I = 1.0$ (Ndertesa, te zakonshme qe nuk i perkasin kategorive te tjera). Ne keto kushte PGA referuese ag_R ne truall te tipit A rezulton: $ag_R=0.298g$ (PGA per periudhe perseritje 475 vjet), kurse nxitimi projektues ne truall te Tipit A: $ag=0.298g \cdot 1.0=0.298g$.

Duke marre ne konsiderate Faktorin e Truallit per Tipin B, $S=1.2$, Nxitimi Projektues per kushtin e "mos-shembjes" per punimet qe do te kryhen rezulton: $ag \cdot S=0.298 \cdot 1.2=0.358g$. Vlera e nxitimit $0.358g$ duhet perdorur per llogaritjet struktureore per kete kusht. Parametrat e tjere jane si vijon: $T_B=0.15$ sek; $T_C=0.50$ sek; $T_D=2.0$ sek.

Te vihet re se vlera e mesiperme $0.358g$ e nxitimit e rekomanduar per projektimin e struktures per kushtin e "mos-shembjes" eshte produkt i nxitimit ne truall te tipit A ($ag=0.298g$) me faktorin e Truallit ($S=1.2$). Neqoftese programi llogarites me te cilin konstruktori dimensionon strukturen, kerkon qe faktori i truallit S te llogaritet (te perfshihet ne program) veças, atehere duhen futur ne program parametrat: $ag=0.298g$ dhe $S=1.2$.

□ Per kushtin e “demtimeve te kufizuara” per spektrin elastik horizontal te projektimit te merret ne konsiderate Faktori i Rendesise sipas EC8 te barabarte me $\gamma_l=1.0$ (Ndertesa, te zakonshme qe nuk i perkasin kategorive te tjera). Ne keto kushte PGA referuese a_gR ne truall te tipit A rezulton: $a_gR=0.148g$, (PGA per periudhe perseritje 95 vjet) kurse nxitimi projektues ne truall te Tipit A: $a_g=0.148g*1.0=0.148g$. Duke marre ne konsiderate Faktorin e Truallit per Tipin B ne kete shesh, $S=1.2$, Nxitimi Projektues per kushtin e “demtimeve te kufizuara” per punimet qe do te kryhen rezulton:

$a_g*S=0.148g*1.2=0.178g$. Vlera e nxitimit $0.178g$ duhet perdorur per llogaritjet struktureore per kete kusht. Parametrat e tjere jane si vijon: $T_B=0.15$ sek; $T_C=0.50$ sek; $T_D=2.0$ sek. Te vihet re se vlera e mesiperme $0.178g$ e nxitimit e rekomanduar per projektimin e struktures per kushtin e “demtimeve te kufizuara” eshte produkt i nxitimit ne truall te Tipit A ($a_g=0.148g$) me faktorin e Truallit ($S=1.2$). Neqoftese programi llogarites me te cilin konstruktori dimensionon strukturen, kerkon qe faktori i truallit S te llogaritet (te perfshihet ne program) veças, atehere duhen futur ne program parametrat: $a_g=0.148g$ dhe $S=1.2$.

□ Per kushtin e “mos-shembjes” per spektrin elastik vertikal te projektimit, nxitimi projektues te merret $avg=0.268g$. Parametrat e tjere jane si vijon: $T_B=0.05$ sek; $T_C=0.15$ sek; $T_D=1.0$ sek.

□ Per kushtin e “demtimeve te kufizuara” per spektrin elastik vertikal te projektimit nxitimi projektues te merret: $avg=0.133g$. Parametrat e tjere jane si vijon: $T_B=0.05$ sek; $T_C=0.15$ sek; $T_D=1.0$ sek.

5. Ne kete analize Faktori i Rendesise sipas EC8, eshte marre i barabarte me 1.0 . Investitori dhe projektuesit e strukturave ne kete projekt mund te aplikojne Faktor Rendesie me te madh se 1.0 , nese ata e konsiderojne te pershtateshme.

7 REFERENCA

ALIAJ, SH., ADAMS, J., HALCHUK, S., SULSTAROVA, E., PECI, V., MUCO, B. (2004) "PROBABILISTIC SEISMIC HAZARD MAPS FOR ALBANIA", 13 WORLD CONFERENCE ON EARTHQUAKE ENGINEERING VANCOUVER, B.C., CANADA, AUGUST 1-6, 2004, PAPER NO. 2469.

AMBRASEYS, N. N., DOUGLAS, J., SARMA, S. K., SMIT, P. (2005). "EQUATIONS FOR THE ESTIMATION OF STRONG GROUND MOTIONS FROM SHALLOW CRUSTAL EARTHQUAKES USING DATA FROM EUROPE AND THE MIDDLE EAST: HORIZONTAL PEAK GROUND ACCELERATION AND SPECTRAL ACCELERATION", BULLETIN OF EARTHQUAKE ENGINEERING, VOL. 13, NO. 1, PP. 1-53.

-BOORE, D., JOYNER, W., FUMAL, T. (1997) "EQUATIONS FOR ESTIMATING HORIZONTAL RESPONSE SPECTRA AND PEAK ACCELERATION FROM WESTERN NORTH AMERICAN EARTHQUAKES: A SUMMARY OF RECENT WORK", SEISMOLOGICAL RESEARCH LETTERS, VOL. 68, NO. 1, PP. 128-153.

-CORNELL, C. A. (1968) "ENGINEERING SEISMIC RISK ANALYSIS" BSS.A, VOL. 58, NO. 5.

-DUNI, LL., KUKA, N. (2003) "DISKUTIRN MBI KOEFICIENTET E SIZMICITETIT DHE SPEKTRAT E REAGIMIT TE KODIT AKTUAL KTP-N.2-89 NE VENDIN TONE", REVISTA "NDERTUESI", NR. 9, DHJETOR 2003, PP. 16-20.

-EUROCODE 8 (2003) "DESIGN OF STRUCTURES FOR EARTHQUAKE RESISTANCE; PART 1: GENERAL RULES, SEISMIC ACTIONS AND RULES FOR BUILDINGS", DRAFT NO. 6; VERSION FOR TRANSLATION (STAGE 49), DOC CEN/TC250 /SC8/N335, EUROPEAN COMMITTEE FOR STANDARDIZATION, JANUARY 2003, PP. 1-30.

-KUKA, N., SULSTAROVA, E., DUNI, LL., ALIAJ, SH. (2003) "THE USE OF SPATIAL SEISMICITY APPROACH FOR THE EVALUATION OF SEISMIC HAZARD OF ALBANIA", IN BOOK OF ABSTRACTS OF SE 40EEE, SKOPJE- OHRID, 26-29 AUGUST 2003, ON CD, PP. 8.

-KUSHTI TEKNIK I PROJEKTIMIT PER NDERTIMET ANTISIZRNIKE KTP-N2-1989. MINISTRIA E NDERTIRNIT DHE AKADEMIJA E SHKENCAVE (QENDRA SIZMOLOGJIKE), TIRANE 1989.

ALIAJ, SH. (1996). NEOTECTONICS OF TIRANA REGION (ALBANIA). PROC. OF THE FIRST WORKING GROUP MEETING INT. PROJECT ON "EXPERT ASSESSMENT OF LAND SUBSIDENCE RELATED TO HYDROGEOLOGICAL AND ENGINEERING GEOLOGICAL CONDITIONS IN THE REGIONS OF SOFIA, SKOPJE AND TIRANA", SOFIA OCTOBER 31-NOVEMBER 3, 1996, PP. 72-81.

ALIAJ, SH. (1997). ACTIVE FAULTS IN TIRANA REGION. PROC. OF THE SECOND WORKING GROUP MEETING, INTER. PROJECT ON "EXPERT ASSESSMENT OF LAND SUBSIDENCE RELATED TO HYDROGEOLOGICAL AND ENGINEERING GEOLOGICAL CONDITIONS IN THE REGIONS OF SOFIA, SKOPJE AND TIRANA", SKOPJE, OCTOBER 29 – 31.

ALIAJ, SH. (1998). NEOTECTONIC STRUCTURE OF ALBANIA. AJNTS, NR.4, TIRANE.

ALIAJ, SH. ET AL. (2001). QUATERNARY SUBSIDENCE ZONES IN ALBANIA: SOME CASE STUDIES". BULL. ENG. GEOL. ENV. 59, PP. 313-318.

ALIAJ, SH., SULSTAROVA, E., MUÇO, B., KOÇIU, S.(2000). SEISMOTECTONIC MAP OF ALBANIA IN SCALE 1:500.000. SEISMOLOGICAL INSTITUTE TIRANA

ALIAJ, SH., DUNI, LL., KUKA, N AND COLLAKU, A.(2003). ENGINEERING-SEISMOLOGICAL STUDY FOR TIRANA CENTER AREA.ARCHIVE OF SEISMOLOGICAL INSTITUTE. TIRANA, JULY 2003.

ALIAJ, SH., KOÇIU S., MUÇO B., SULSTAROVA E. (2010). SIZMICITETI, SIZMOTEKTONIKA DHE RREZIKU SIZMIK I SHQIPERISE. BOTIM I AKADEMISESE SHKENCAVE TE SHQIPERISE.

DHIMITER PAPA (2023). RAPORT MBI KUSHTET GJEOLIGO-INXHINIERIKE TE SHESHIT TE NDERTIMIT TE OBJETKIT "NDERTIMI I QENDRES SE INTEGRUAR NE FUNKSION TE SHERBIMEVE TE ADM PUBLIKE"

DUNI LL., KUKA N. (2003). SEISMIC HAZARD ASSESSMENT AND SITE-DEPEDENT RESPONSE SPECTRA PARAMETERS OF THE CURRENT SEISMIC DESIGN CODE IN ALBANIA. CONFERENCE OF CEI, SOFIA, 4-5 NOVEMBER 2003, ON CD.

EUROCODE 8: DESIGN OF STRUCTURES FOR EARTHQUAKE RESISTANCE, PART 1: GENERAL RULES, SEISMIC ACTIONS AND RULES FOR BUILDINGS. CEN 2003.

KOÇIAJ S., ALIAJ SH., PITARKA A., PEÇI V., KONOMI N., DAKOLI H., PRIFTI K., KOÇIU A., KERO J., SHEHU V., GOGA K., GORO N., KUME L., KAPLLANI L., PAPADHOPULLI P., EFTIMI R., KONDO M., PUKA N. (1988). MIKROZONIMI SIZMIK I QYTETIT TE TIRANES. INSTITUTI SIZMOLOGJIK, TIRANE.

KONOMI, N. ET AL. (1988). ENGINEERING GEOLOGY ZONATION OF TIRANA CITY. TECHNICAL REPORT, ARCHIVE OF GEOLOGY AND MINE FACULTY, TIRANE, (IN ALBANIAN).

KUSHTI TEKNIK I PROJEKTIMIT PER NDERTIMET ANTISIZMIKE KTP-N2-1989. MINISTRIA E NDERTIMIT DHE AKADEMIJA E SHKENCAVE (QENDRA SIZMOLOGJIKE), TIRANE 1989.

SADIGH K., C.-Y. CHANG, J.A. EGAN, F. MAKDISI, AND R.R. YOUNGS (1997). ATTENUATION RELATIONSHIPS FOR SHALLOW CRUSTAL EARTHQUAKES BASED ON CALIFORNIA STRONG MOTION DATA. SEISMOLOGICAL LETTERS 68 (1), 180-189.

SPUDICH, P., JOYNER, W.B., LINDH, A.G., BOORE, D.M., MARGARIS, B.M. AND FLETCHER, J.B. (1999). SSEA99: A REVISED GROUND MOTION PREDICTION RELATION FOR USE IN EXTENSIONAL TECTONIC REGIMES. BULLETIN OF THE SEISMOLOGICAL SOCIETY OF AMERICA 89 (5), 1156 -1170.

SULSTAROVA E., MUÇO B., KOÇIU S. (2006). KATALOGU I TERMETEVE TE SHQIPERISE ME $M_S \geq 4.5$. ARKIVI I INSTITUTIT SIZMOLOGJIK, TIRANE.

SHAKE 2000 – A COMPUTER PROGRAM FOR THE 1-D ANALYSIS OF GEOTECHNICAL EARTHQUAKE ENGINEERING PROBLEMS. GUSTAVO A. ORDONEZ. JULY 2001 – REVISION, UPDATED JULY 2013.

TECHNICAL REPORT FOR THE PEER GROUND MOTION DATABASE WEB APPLICATION, BETA VERSION, OCOBER 2010.



Matjjet me metoden sizmike MASW

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA TIRANE

RELACIONI TOPOGRAFIK

FAZA PROJEKT ZBATIMI

**INVESTIME PËR TRANSFORMIMIN E ASETEVE
PUBLIKE ME POTENCIAL ZHVILLIMI NË MODELE
TË STANDARTIT MË TË LARTË TË ZHVILLIMIT,
LOTI 1 “PARKU MULTIFUNKSIONAL, TIRANË
TIRANE**

PROJEKTUES : ARKONSTUDIO

PERGATITI:

Ing.DODE MARKU

Lic.Nr :T.1164/1



TIRANE 2023

PERMBAJTJA

1	TE PERGJITHSHME	3
1.1	Informacion i pergjithshem.....	3
2	TE PERGJITHSHME	4
2.1	Informacion i pergjithshem.....	4
2.2	Zhvillimi i Nivelimit Gjeometrik	6
2.3	Rilevimi	6
2.4	Pershkrimi i punes ne terren.....	7
2.5	Puna ne terren	7
2.6	Puna ne zyre	11

RELACIONI TOPOGRAFIK

Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standartit më të lartë të zhvillimit, Loti 1 “Parku Multifunksional, Tiranë

1 TE PERGJITHSHME

1.1 Informacion i përgjithshëm

Ky Studim topografik është bërë në zonën e rrugëve në studim për objektin: Ndërtimi i qendres së integruar në funksion të shërbimeve të administratës publike në bashkinë e Tiranës. Më poshtë po paraqesim planimetritë e shtrirjes së rrugëve në lidhje me zonën.




Figure 1 – Gjurma ekzistuese e godinave të administratës

RELACIONI TOPOGRAFIK

Investime për transformimin e asetëve publike me potencial zhvillimi në modele të standartit më të lartë të zhvillimit, Loti 1 “Parku Multifunksional, Tiranë

2 TE PERGJITHSHME

2.1 Informacion i përgjithshëm

Punimet gjeodezike dhe topografike për projektimin e godines se administrates me emrtim: **Investime për transformimin e asetëve publike me potencial zhvillimi në modele të standartit më të lartë të zhvillimit, Loti 1 “Parku Multifunksional, Tiranë** u kryen mbi bazen e kërkesave teknike të përgjithshme dhe specifike të parashikuara nga Autoriteti Kontraktor. Punimet u kryen nga topografet e studios sone të projektimit .

“ARKONSTUDIO” Sh.p.k organizoi punen dhe zhvilloi punimet ne baze te pervojes se perftiuar ne punimet e meparshme te kesaj natyre. Para fillimit te punimeve topografike u siguruan materialet e nevojshme hartografike, gjeodezike si dhe paisjet perkatese.

Per te siguruar lidhjen gjeodezike unike te te gjithë projekteve nga firma u shfrytezuan te dhenat gjeodezike te rrjetit shteteror te triangulacionit dhe nivelimit.

Sistemi qe perdor Republika e Shqiperise eshte projeksioni Gauuss Kryger-it me ellipsoid Krasovsky-n. Rilevimi eshte bere ne sistemin nderkombetar me projeksionin UTM me ellipsoid WGS84. Duke patur parasysh zonen dhe ritmin e zhvillimit qe ajo ka ,do te ishte me frytedhense nese do te perdorej dhe ky sistem . Me kete sistem mund te percaktohet lehtesisht kordinatat gjeodezike per cdo pike mbi siperfaqen tokesore nepermjet perdorimit te GPS.

Gjate rikonicionit ne terren u vendosen pikat e triangulacionit dhe markat e nivelimit ne pikat e fiksuara ne teren. Pikat e fiksuara ne teren u paisen me koordinata ne projeksionin UTM ellipsoid WGS84 dhe kuota .Para fillimit te rilevimit u krye pernjohja e detajuar e terrenit, e cila sherbeu per percaktimin e sakte te metodikes se punes, menyren e ndertimit te rrjetit gjeodezik, poligonometrise se rilevimit, nivelimit teknik si dhe organizimit te punes.

Fiksimi ne terren i pikave te rilevimit u krye me kunjat hekuri me gjatesi 20 - 30 cm te futur toke. Ato jane vendosur ne vende te dukeshme dhe te pa levizeshme. Identiteti i tyre eshte fiksuar me boje te kuqe te shkruajtur ne afersi te pikes fikse ne vende te dukeshme nga rruga ekzistuese ose tereni. Ato jane vendosur ne vende te qendrushme, ne ane te rruges ose afer saj, kane pamje te ndersjellte, duke siguruar ne kete menyre lidhjen dhe vazhdimesine e punes nga faza e projektimit ne ate te zbatimit te tij. Çdo pike e fiksuar ne terren ka numerin, koordinatat te saj, si dhe lartesine te perftuar nepermjet nivelimit gjeometrik e gjeodezik (shih planimetritë e objekteve ku gjenden koordinatat

tre dimensionale te pikave mbeshtetese). Keto te dhena sigurojne gjetjen e tyre me lehtesi ne terren.

Pikat fikse te terrenit jane te percaktuara ne planimetrine e veçante te projektit : *Investime për transformimin e asetëve publike me potencial zhvillimi në modele të standartit më të lartë të zhvillimit, Loti 1 “Parku Multifunksional, Tiranë*

RELACIONI TOPOGRAFIK

Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standartit më të lartë të zhvillimit, Loti 1 “Parku Multifunksional, Tiranë

I gjithë procesi topografik konsiston në krijimin e një harte dixhitale me një gjerësi rreth nga 25m-30m për gjithë gjatësinë e segmentit. E gjithë puna filloi me rikonjicionin e terrenit dhe ndertimin e stacioneve gjatë gjithë gjatësisë së rrugës (te cilët do të përdoren dhe gjatë ndertimit të vepres).

Punët topografike për ndertimin e kësaj harte konsistojnë në hapat e mëposhtme:

1. Ndertimi i Stacioneve & Matja e tyre me GPS
2. Matja me instrument dhe regjistrimi me emere të vecante e pikave të terrenit dhe të të gjitha elementeve të tjere që gjenden në rrugë si trotuare ,bordura, mure rrethues, puseta , shtylla etj..
3. Trasportimi i të dhënave të matura në terren në programet përkatëse gjeodezike

Figure 2 – Plani i Përgjithshëm i projektit



RELACIONI TOPOGRAFIK

Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standartit më të lartë të zhvillimit, Loti 1 “Parku Multifunksional, Tiranë

2.2 Zhvillimi i Nivelimit Gjeometrik

Per te siguruar kerkesat e larta teknike ne punimet rievuse, u percaktua qe saktesia altimetrike e punimeve topografike te jete e larte dhe per kete qellim u zhvillua nivelim gjeometrik per pikat e poligonometrise ne te gjithë sektoret e rruges.

Nivelimi gjeometrik u krye me nivelen teknike te tipit Kern Level, me metoden e nivelimit teknik te dyfishte, duke matur çdo disnivel dy here, me dy vendosje instrumenti. Diferenca midis dy disniveleve te perftuar ne çdo stacion nuk u lejua me teper se 3 mm.

2.3 Rilevimi

Duke u mbeshetur ne pikat e poligonometrise dhe te nivelimit gjeometrik u zhvillua rrjeti i matjevetopografike ne *Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standartit më të lartë të zhvillimit, Loti 1 “Parku Multifunksional, Tiranë*

Eshte rievuar rruga egzistuse, kanale, pusete, platforme betoni ,shtylla ndricimi ose tensioni,bunkere,tombino ,trotuare, ure, ndertesa, objekte te ndryshem, rruge dytesore etj. Objektet e pare ne teren jane hedhur ne relief te gjithë. Punimet topogjeodezike te kryera jane mbeshetur ne shkallen e plote te pergatitjes profesionale, ne perdorimin e teknologjive bashkekohore per matjet fushore dhe perpunimin kompjuterik te te dhenave, per te plotesuar kerkesat teknike te parashtruara nga projektuesit. Çdo pike e mare ne teren ka koordinata tre dimensionale, te paraqitura ne projekt.

Perpunimi i materialit topografik ne zyre eshte bere me programin STRATO dhe LEONARDO,TGO,Autocad Land Development nga ku eshte perftuar rievimi ne komunen Ishem.Ky relief sherbeu per hartimin e projektit te zbatimit me saktesine dhe cilesine e kerkuar ne termat e references nga investitori.

Ne materialin grafik te projektit jepet planimetria e fiksimeve dhe tabela e koordinatave te pikave te vendosura ne terren.

RELACIONI TOPOGRAFIK

Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standartit më të lartë të zhvillimit, Loti 1 “Parku Multifunksional, Tiranë

2.4 Pershkrimi i punes ne terren.

Per mbeshtetjen e punimeve fillimisht u krijuan 2 pika te forta te cilat jane te mjaftueshme per kryerjen e pikave detaje te rilevimit . Matja e ketyre pikave u kryen me metoden statike duke qendruar ne pike rreth 40 min ne intervalin 1 sek duke siguruar saktesi milimetrike te koordinatave te pikave.

Prania e marresit baze ne largesi te kufizuar siguron saktesi me te larte te matjeve ne interval kohe me te shkurter.

Keshtu per pikat deri ne 1km nga marresi baze u perdor intervali 10 sek me matje per çdo sekonde ndersa per largesi me te madhe deri ne 2 km intervali 15 sek. Element kryesor ne matjen ‘stop&go’ eshte mos humbja e lidhjes se fazes bartese gje e cila prish zgjidhjen perfundimtare. Kjo mund te realizohet duke shmatur futjen ne zona hije te sinjalit ose zona me reflektim te madh sinjali. Ne kete rast marresit GPS KOLIDA K5 UFO japin nje sinjal i cili lajmeron matesin se duhet te rifilloje matjen nga nje pike matur paraprakisht, duke siguruar saktesine e kerkuar. Ne zonat me dendesi ndertimesh u perdor Stacioni Total pasi kishte peme dhe ndertime te larta te cilat nuk lejojne matjen e pikave detaje me GPS.

2.5 Puna ne terren

Zona qe eshte rilevuar shtrihet ne zonen e Farkes, Bashkia Tirane qe u rilevua ndodhet ne nje gjendje shum te keqe si rezultat I mungeses se investimeve si dhe veprimit te agjenteve atmosferik. ne shum pjese te saje eshte e demtuar ku ne te gjith gjatesin e tij mungojne veprat e artit si ,mure ,tombino etj.

Puna e rilevimit u krye nga 1 grup topografik te koordinuar nga nje topograf me eksperience ne projekte te ngjashme.

RELACIONI TOPOGRAFIK

Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standartit më të lartë të zhvillimit, Loti 1 “Parku Multifunksional, Tiranë



SIPËRFAQJA TOTALE E NDËRTIMEVE FUNKSIONAVE : 6'767 m²
SIPËRFAQJA TOTALE E NDËRTIMEVE TË DEGRADUARA: 9'415 m²

RELACIONI TOPOGRAFIK

Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standartit më të lartë të zhvillimit, Loti 1 “Parku Multifunksional, Tiranë

Koordinatat e godinave te administrates sipas projektit



RELACIONI TOPOGRAFIK

Investime për transformimin e asetëve publike me potencial zhvillimi në modele të standartit më të lartë të zhvillimit, Loti 1 “Parku Multifunksional, Tiranë

Matjet u kryen me GPS KOLIDA K5 UFO, Stacion Total të tipit KOLIDA, të cilët teknikisht sigurojnë matjet e këndeve e largësive me saktësinë e nevojshme për piketimin e objekteve.



GPS KOLIDA K5

Stacion Total KOLIDA

Stacion TOPCON OS105



RELACIONI TOPOGRAFIK

Investime për transformimin e asetëve publike me potencial zhvillimi në modele të standartit më të lartë të zhvillimit, Loti 1 “Parku Multifunksional, Tiranë

2.6 Puna ne zyre

Te gjitha elementet dhe detajet topografike jane te regjistruar me kode te vecante ne memorien e brendshme dixhitale te instrumentave te perdorur nga Konsulenti.

Tek keto elemente perfshihen shtresat rrugore, bankinat e asfaltuara, skarpatat ne mbushje dhe ne germim, veprat e artit (urat, tombinot etj.), kryqezimet, kanalet anesore, perrenjte, lumenjte, punimet per mbrojtjen e skarpatave anesore, kanalet ujites, strukturat ujites, punimet per mbrojtjen nga permbytjet, mure mbajtes dhe akustike, mbrojtset anesore (guardrails), pemet, ndertesat, hekurudhat, linja elektrike, ujesjelles, kryqezime rruges etj., te cilat jane memorizuar me kodet perkatese.

Mbas punes ne terren eshte bere perpunimi i te dhenave te matura ne terren me anen e programit Autodesk Civil3d. Pikat e rilevuara jane hedhur ne AutoCAD ku eshte bere dhe lidhja e elementeve (bazuar tek kodet) e te gjithe zones duke krijuar nje vizatim unik. Vizatimi eshte bere ne 3 dimensione, ne menyre qe mund te krijojme modelin e terrenit ne menyre dixhitale. Jane paraqitur te gjitha detajet e relievit si rruge, ura, tombino, perrenj, lumenj, mure, ndertesat, rrethime, linja elektrike, etj. ne layera te vecanta. Te gjitha stacionet jane paraqitur me shenje konvencionale ne vizatim.

Modeli dixhital i terrenit eshte paraqitur ne file dwg si me poshte:

1. Tre - dimensional (x,y,z), pika gjeodezike ne nje shtrese te vetme
2. Tre - dimensional (x,y,z) linjat e nderprerjes se terrenit, si dhe elemente te tjere topografike te terrenit ne shtresat perkatese.

RELACIONI ARKITEKTONIK

Objekti :

" INVESTIME PËR TRANSFORMIMIN E ASETETEVE
PUBLIKE ME POTENCIAL ZHVILLIMI NË MODELE TË
STANDARTIT MË TË LARTË TË ZHVILLIMIT, LOTI 1
"PARKU MULTIFUNKSIONAL, TIRANË "



POROSITES : FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

PROJEKTUES : "ARKONSTUDIO SH.P.K."

License N.6996/7



1. INFORMACIONE DHE TE DHENA PER PROJEKTIN

2. POZICIONIMI I OBJEKTIT

Objekti pozicionohet ne qytetin e Tiranës pozicionohet ne pjesen Jugore te tij. Mundësohet aksesim ne objekt nepermjet rruges “Rezervat e Shtetit”.




• FUNKSIONET E OBJEKTIT

Objekti aktualisht permban hapësira shërbimi sic janë : zyra administrative, arkive, muze, sale konferencash, bar kafe dhe hapësira shërbuese : parking, kuzhine, depo etj.,.

Relacion Arkitektonik



Aktualisht ne objekt jane objekte te rrenuara te cilat do te prishen dhe pasi te pastrohet sheshi do te rindertoet objekti i ri me 4k.



Plani i objekteve egzistuese

Objektet qe do prishen te kufiri i administrates jane 542 m²+1088 m²+883 m²+550 m².

3. PERSHKRIMI I PRONES

Objekti i perket njesise strukturore FA/63 sipa te dhenave te marra nga AKPT.



Relacion Arkitektonik





4. PROPOZIMI I PROJEKTIT

Nisur nga detyra e projektimit ne projekt ehste parashikuar te realizohet ndertimi i nje godine te re 4k mbitoke e cila do jete me e ndare ne 2 funksione baze

A) Hapesira Sherbimi:


- Zyra Administrative
- Arkive
- Muze
- Salle Konferencash
- Bar Kafe

B) Hapesira Sherbyese:

- Parking
- Kuzhine

Relacion Arkitektonik

- Depo
- Nhs
- Shkalle-Ashensor



PLANVENDOSJA

TREGUES TE ZHVILLIMIT

Sipërfaqja E Tokës Që Zhvillohet - 6,618.36m²

Sipërfaqja E Tokës E Zënë Nga Struktura- 2,386.61 M²

Sipërfaqe Totale E Ndertimit Mbi Toke - 7,281.25 M²

Sipërfaqe Totale E Ndertimit Nentoke - 2362.58 M²

Intesiteti I Ndertimit 1.1

Koeficient Shfrytezimi Te Truallit 36 %

Lartesia Maksimale E Struktures 13.74 M

Sipërfaqje E Gjelber 143.2 M²

Distancat Nga Kufiri I Pronës:

Veri- Perendim-

0.8 - 5.1 M Nga Kufiri I Pronës Për Volumin 4 Kat

2.3 M -+Nga Kufiri I Pronës Për Volumin 3kat

Veri-Lindje

Relacion Arkitektonik

4.1 - 6.7 M Nga Kufiri I Pronës Për Volumin 4 Kat

4.2 M Nga Kufiri I Pronës Për Volumin 3kat

Jug-Lindore 1.5 M Nga Kufiri I Pronës Për Volumin 4 Kat

Jug 17.1 M - 47.9 M Nga Kufiri I Pronës Për Volumin 4kat

Jug- Perendim 25.6 M Nga Kufiri I Pronës Për Volumin 4kat

Perendim 9.7-12.5 M Nga Kufiri I Pronës Për Volumin 4kat

Distancat Nga Trupi I Rrugës:

Jug 40.7 M Nga Trupi I Rrugës I Propozuar Për Volumin 4kat

Distancat Nga Objektet Kufitare:


Veri 33.3 M Nga Volumi 4 Kat (Administra) Me Objektin 2 Kat

Veri 35.2 M Nga Volumi 4 Kat (Adminstrata) Me Objektin 2 Kat

Veri -Lindje 37.7 M Nga Volumi 3 Kat (Adminstrata) Me Objektin 2 Kat

5. PLANIMETRIT E OBJEKTIT

Planimetri Teknike Ne Kuoten -4.32



Planimetri Mobilimi Ne Kuoten +0.00

Relacion Arkitektonik



Planimetri Teknike Ne Kuoten +4.08



Planimetri Teknike Ne Kuoten +8.16




6. FASADAT

Fasadat e objektit te Administrates trajtohen me disa materiale.

Ne fasaden kryesore, pamja 1 kemi xham struktural, elemente hijezimi vertikale, alukobond dhe vetrata xhami.

Fasada Jugore

Fasada Jugore



Fasada Veriore


Kemi keto elemente: xham struktural, elemente hijezimi vertikale, alukobond dhe vetrata xhami.



Fasada Juglindore

Kemi keto elemente: xham struktural, elemente hijezimi vertikale, alukobond dhe vetrata xhami.


Fasada Jug- Lindore



Fasada Perendimore

Kemi keto elemente: xham struktural, elemente hijezimi vertikale, alukobond dhe vetrata xhami.

Fasada Perendimore



Objekti i administrates do te jete i sfazuar ne 2 shkalle .


Ne pjesen veriore te tij ai kufizohet me turtle park dhe kuota e katit te pare do te sherbeje ne te ardhmen edhe si hyrje e pasme e objektit. Ajo do te aksesohet ne te njejten kuote sistemimi si parku kurse pjesa jugore do te aksesohet nga ana e parkimit te vete objektit dhe hyrja eshte ne kuote -4.32 referuar sistemimit te parkut kurse ne pjesen jugore do te aksesohet ne te njejtn kuote me parkimin.

Administrata do te jete nje objekt i rrethuar i cili pas ndertimit hyrjen e tij e ka nga rruga e re qe do te ndertohtet.


Ne kontur te tij do te jete i rrethuar me trotuar dhe drenazhim anesor dhe perimetri i tij do te mund te aksesohet nga punonjesit.

7. PRERJET


PRERJA 2-2



PRERJA 1-1




PRERJA 3-3




Ky objekt do te trajtohet me sistem kapote ne fasade dhe njekohesisht me fasade alukobondi.

DETAJI I TARRACES DHE MURIT TE JASHEM (D 1)




Ne pjesen e jashtme te tij do te sistemohet i gjithe sheshi me pllaka trotuari dhe me asfalt.

DETAJ TROTUARI (D 4)



DETAJ I RRUGES (D 5)



Hyrja ne objekt do te jete me porte me mekanizem ne menyre qe te aksesohet ne menyre te kontrolluar dhe do jete e pajisur me tra ne hyrje.

Pjesa e sheshit te parkimit do te jete e ndricuar me ndricues 7 m dhe me sinjalistiken e duhur te parkimit te makinave.

PAMJE 3 DIMENSIONALE

Relacion Arkitektonik



Relacion Arkitetnik



RELACION TEKNIK

